

L I G J I N

PËR NDALIMIN E DISKRIMINIMIT

I. DISPOZITAT THEMELORE

Objekti i ligjit

Neni 1

Ndalimi dhe mbrojtja nga diskriminimi realizohen në pajtim me këtë ligj.

Për ndalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi zbatohen edhe dispozitat e ligjeve të tjera me të cilat rregullohet ndalimi dhe mbrojtja nga diskriminimi në baza të veçanta ose lidhur me realizimin e drejtave të veçanta, nëse nuk janë në kundërshtim me këtë ligj.

Ndalimi i diskriminimit

Neni 2

Ndalohet çdo formë e diskriminimit, mbi çdo lloj baze.

Diskriminimi është bërja e çdo dallimi të paarsyeshëm, juridik apo faktik, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë apo trajtimi i pabarabartë, gjegjësisht anashkalimi i trajtimit ndaj një personi, gjegjësisht, një grupi personash në raport me personat e tjerë, si dhe përjashtimi, kufizimi ose dhënia përparësi ndonjë personi në raport me personat e tjerë, që bazohet në racën, ngjyrën e lëkurës, përkatësinë nacionale, prejardhjen shoqërore apo etnike, lidhur me ndonjë popull pakicë ose bashkësi nacionale pakicë, gjuhën, fenë apo bindjen, mendimin politik apo mendim tjetër, seksin, identitetin gjinor, orientimin seksual, gjendjen shëndetësore, invaliditetin, moshën, gjendjen materiale, gjendjen martesore apo familjare, përkatësinë ndaj grupit ose supozimin mbi përkatësinë ndonjë grupi, partinë politike ose ndonjë organizatë tjetër, si dhe karakteristikat e tjera personale.

Diskriminimi i drejtpërdrejtë ekziston nëse me akt, veprim ose mosveprim, personi ose një grup personash, në situatë të njëjtë ose të ngjashme, çojnë ose kanë çuar, gjegjësisht mund të jenë çuar në pozitë të pabarabartë në raport me personin apo një grup personash sipas ndonjëres nga bazat e paragrafit 2 të këtij neni, përveç, nëse ky akt, veprim ose mosveprim është objektiv dhe i justifikuar qartë me qëllime ligjore, me përdorimin e mjeteve që janë të përshtatshme dhe të domosdoshme për arritjen e qëllimit, gjegjësisht në raport të pranueshëm proporcional me qëllimin që dëshirohet të arrihet.

Diskriminimi i tërthortë ekziston nëse rregullorja neutrale false e dispozitës ose aktit të përgjithshëm, kriteri apo praktika çojnë ose do të mund të çonin personin ose një grup personash në pozitë të pabarabartë në raport me personat apo një grup personash të tjerë, sipas ndonjëres nga bazat e paragrafit 2 të këtij neni, përveç nëse ky akt, kriter ose praktikë është objektiv dhe i justifikuar qartë me qëllimin ligjor, përdorimin e mjeteve që janë të përshtatshme dhe të domosdoshme për arritjen e qëllimit, gjegjësisht në raport të pranueshëm proporcional me qëllimin që dëshirohet të arrihet.

Diskriminim konsiderohet edhe nxitja ose dhënia e instruksioneve që një person i caktuar ose një grup personash të diskriminohen sipas ndonjëres nga bazat e paragrafit 1 të këtij neni.

Mbrojtja nga diskriminimi

Neni 3

E drejta për mbrojtje nga diskriminimi u takon të gjithë personave fizikë dhe juridikë ndaj të cilëve zbatohen dispozitat e Malit të Zi, nëse janë të diskriminuar për diçka në bazë të nenit 2, paragrafi 2, i këtij ligji.

Personat që denoncojnë diskriminimin

Neni 4

Askush nuk mund të dëmtohet për shkak të denoncimit të rastit të diskriminimit, deklarimit para organit kompetent ose ofrimit të dëshmive në procesin në të cilin hetohet rasti i diskriminimit.

Masat e veçanta

Neni 5

Masat e veçanta që janë të drejtuara në krijimin e kushteve për realizimin e barazisë nacionale, gjinore dhe të barazisë së plotë, si dhe mbrojtjen e personave që në cilëndo bazë janë në pozitë të pabarabartë mund të marrin organet shtetërore, organet e administratës shtetërore, organet e njësisve të vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjet publike dhe personat e tjerë juridikë të cilët kryejnë kompetencat publike (në tekstin e mëtejme: organet), si dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë.

Masat nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohen në përputhshmëri me nevojat dhe mundësitë dhe zgjasin deri në realizimin e qëllimeve që janë përcaktuar më këto masa.

Pëlqimi

Neni 6

Pëlqimi i personit që të jetë i diskriminuar nuk e liron nga përgjegjësia personin që kryen diskriminimin, jep instruksione ose nxit kryerjen e diskriminimit.

II. FORMAT E VEÇANTA TË DISKRIMINIMIT

Shqetësimi

Neni 7

Shqetësimi, sipas ndonjërës nga bazat e nenit 2, paragrafi 2 të këtij ligji, paraqet sjelljen ose veprimin e caktuar ndaj ndonjë personi, që nuk e dëshiron një sjellje ose veprim të tillë, e që ka për qëllim ose paraqet shkeljen e dinjitetit personal ose shkakton frikë, siklet, armiqtësi, përlulje ose ofendim.

Mobingu (bezdia)

Neni 8

Mobingu është sjellje në vendin e punës, me të cilën një ose shumë persona, në një periudhë të gjatë kohore, e keqtrajtojnë në mënyrë psikike ose e përuhin sistematikisht një person tjetër me fyerje, nënçmime, shqetësime dhe me aktivitete të tjera dhe e sjellin këtë person në pozitë të pabarabartë sipas ndonjërës nga bazat e nenit 2, paragrafi 2 të këtij ligji, çka ka për qëllim rrezikimin e reputacionit të tij/saj, nderit, dinjitetit dhe integritetit, e mund të shkaktojë edhe pasoja të dëmshme të natyrës mentale,

psikosomatike dhe shoqërore ose të sjellë në pyetje ardhmërinë profesionale të personit që është viktimë e mobingut.

Segregacioni

Neni 9

Segregacioni është çdo ndarje e një personi apo një grupi personash sipas ndonjëres nga bazat e nenit 2, paragrafi 2, të këtij ligji, përveçse në rastet kur ndarja është objektive dhe e arsyeshme, kurse mënyra për arritjen e këtij qëllimi është e domosdoshme dhe proporcionale.

Diskriminimi në shfrytëzimin e objekteve dhe sipërfaqeve në përdorim publik

Neni 10

Kufizimi ose parandalimi i shfrytëzimit të objekteve dhe sipërfaqeve në përdorim publik një personi ose një grupi personash, sipas ndonjëres nga bazat e nenit 2, paragrafi 2 të këtij ligji, konsiderohet si diskriminim.

E drejta e shfrytëzimit të objekteve dhe sipërfaqeve në përdorim publik mund të kufizohet vetëm në pajtim me ligjin.

Diskriminimi në ofrimin e shërbimeve publike

Neni 11

Diskriminim në fushën e ofrimit të shërbimeve publike, sipas ndonjëres nga bazat e nenit 2 paragrafi 2 të këtij ligji, konsiderohet:

- 1) vështirësimi ose parandalimi i ofrimit të shërbimeve publike;
- 2) refuzimi i ofrimit të shërbimeve publike;
- 3) kushtëzimi i ofrimit të shërbimeve publike të cilat nuk kërkohen nga personat ose grup personat e tjerë;
- 4) vonesa me qëllim ose shtyrja e ofrimit të shërbimeve, edhe pse personi ose një grup personash ka kërkuar dhe i ka plotësuar në kohë kushtet për ofrimin e shërbimeve para personave të tjerë.

Diskriminimi në bazë të gjendjes shëndetësore

Neni 12

Parandalimi, kufizimi ose vështirësimi i punësimit, punës, shkollimit ose bërja e çdo dallimi tjetër të pa bazë si dhe trajtimi i pabarabartë ndaj personit ose një grupi personash, në bazë të gjendjes shëndetësore, konsiderohet si diskriminim.

Diskriminimi në bazë të moshës

Neni 13

Parandalimi ose kufizimi i realizimit të drejtave ose bërja pa bazë e çdo dallimi tjetër si dhe trajtimi i pabarabartë ndaj një personi ose një grupi personash, në bazë të moshës, konsiderohet si diskriminim.

Diskriminimi politik

Neni 14

Ndalohet diskriminimi i individëve ose i një grupi personash për shkak të bindjeve politike, për shkak të përkatësisë ose pa përkatësisë në partinë politike ose një organizatë tjetër.

Diskriminimi në fushën e edukimit, arsimimit dhe aftësisë profesionale

Neni 15

Me diskriminim në fushën e edukimit, arsimimit dhe aftësisë profesionale konsiderohet vështirësi ose parandalimi i regjistrimit në institucionin edukativo-arsimor dhe institucionin e arsimit të lartë dhe zgjedhja e programit arsimor në të gjitha nivelet e edukimit dhe arsimimit, përjashtimi nga këto institucione, vështirësi ose mohimi i mundësisë për ndjekjen e mësimi dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e tjera edukative, gjegjësisht arsimore, klasifikimi i fëmijëve, nxënësve/eve, frekuentuesve/eve dhe studentëve/eve, keqtrajtimi ose ndonjë mënyrë tjetër e bërjes së dallimeve të paarsyeshme ose trajtimi i pabarabartë ndaj tyre, sipas ndonjërisë nga bazat e nenit 2, paragrafi 2 të këtij ligji.

Diskriminimi në fushën e punës

Neni 16

Krahas rasteve të diskriminimit të përcaktuara me ligjin me të cilin rregullohet fusha e punës dhe punësimit, me diskriminim në punë konsiderohen edhe të ardhurat e pabarabarta, gjegjësisht shpërblimet për punë me vlerë të barabartë personit apo një grupi personash, sipas ndonjërisë nga bazat e nenit 2 paragrafi 2 të këtij ligji.

Të drejtën për mbrojtje nga diskriminimi sipas paragrafit 1 të këtij neni e kanë edhe personat që kryejnë punë periodike dhe provizore ose punë me kontratë të veçantë, studentët/et ose nxënësit/et në praktikë, si dhe personat e tjerë që në cilëndo bazë marrin pjesë në punë tek punëdhënësi.

Nuk konsiderohet diskriminim bërja e dallimeve, përjashtimi ose dhënia përparësi për shkak të karakteristikave të punës tek e cila karakteristikat personale të personit paraqesin kusht real dhe vendimtar për kryerjen e punës, nëse qëllimi që dëshirohet të arrihet është i justifikueshëm me këtë, si dhe marrja e masave mbrojtëse në bazë të disa kritereve të veçanta të personave sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Diskriminimi në bazë të besimit dhe të bindjes

Neni 17

Diskriminim konsiderohet çdo dallim, trajtim i pabarabartë dhe sjellje në pozite të pabarabartë të personit apo të një grupi personash në bazë të besimit ose bindjespërkatësisë ose jo përkatësisë të ndonjë komuniteti fetar.

Diskriminimi i personave me invaliditet

Neni 18

Me diskriminim të personit me invaliditet konsiderohet, posaçërisht: pamundësia ose vështirësi i përfshirjes në mbrojtjen shëndetësore, gjegjësisht mohimi i të drejtës së mbrojtjes shëndetësore, trajtimet e rregullta mjekësore dhe ilaçet, mjetet dhe masat për rehabilitim; mohimi i të drejtës së shkollimit, gjegjësisht arsimimit; mohimi i të drejtës së punës dhe të drejtave në bazë të punësimit, në pajtim me nevojat e këtij personi; mohimi i

të drejtës së martesës, në krijimin e familjes dhe të drejtave të tjera në fushën e raporteve martesore dhe familjare.

Mos ofrimi i qasjes ndaj objekteve dhe sipërfaqeve në përdorim publik personave me lëvizshmëri të kufizuar dhe personave me invaliditet, gjegjësisht parandalimi, kufizimi dhe vështirësimi i shfrytëzimit të objekteve të përmendura, në mënyrën që paraqet ngarkesë jo proporcionale për personin juridik ose fizik i cili është i detyruar ta sigurojë këtë, konsiderohet diskriminim sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Diskriminimi i personave me invaliditet ekziston edhe në rastin kur nuk merren masat e posaçme për të mënjeluar kufizimet, gjegjësisht pozitën e pabarabartë në të cilën gjenden ata persona.

Diskriminimi në bazë të identitetit gjinor dhe orientimit seksual **Neni 19**

Çdo bërje e dallimit, trajtim i pabarabartë ose çuarje në pozitë të pabarabartë të personit në bazë të identitetit gjinor ose orientimit seksual, konsiderohet diskriminim.

Gjithkush ka të drejtë të shprehë identitetin e vet gjinor dhe orientimin seksual.

Identiteti gjinor dhe orientimi seksual janë çështje private e çdo personi dhe askush nuk mund të ftohet që të deklarohet publikisht për identitetin e vet gjinor dhe orientimin seksual.

Formë e rëndë diskriminimi **Neni 20**

Me formë të rëndë të diskriminimit, sipas ndonjëres nga bazat e nenit 2, paragrafi 2 të këtij ligji, konsiderohet diskriminimi:

- 1) i kryer ndaj të njëjtit person apo grupi personash sipas shumë bazave të nenit 2, paragrafi 2, të këtij ligji (diskriminimi i shumëfishtë);
- 2) i kryer shumë herë ndaj të njëjtit person apo grupi personash (diskriminimi i përsëritur);
- 3) i kryer në një periudhë të gjatë kohore ndaj të njëjtit person apo grupi personash (diskriminim i vazhduar);
- 4) me propagandim nëpërmjet medimeve publike, si dhe shkrimi ose shfaqja e përmbajtjeve dhe simboleve me përmbajtje diskriminuese në vendet publike;
- 5) që ka veçanërisht pasoja të rënda ndaj personit të diskriminuar, grupit të personave ose pasurisë së tyre.

III. MBROJTËSI/JA E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT

Kompetencat e Mbrojtësit/es **Neni 21**

Krahas autorizimeve dhe kompetencave të përcaktuara me ligj të veçantë, Mbrojtësi/ja e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (në tekstin në vazhdim: Mbrojtësi/ja) ka të drejtë që:

- 1) paraqitësit/es të ankesës i cili/a konsideron se është i/e diskriminuar nga ana e personit fizik apo juridik, t'i japë sqarimet e nevojshme për të drejtat dhe detyrimet e tij/saj, si dhe mundësitë gjyqësore dhe format e tjera të mbrojtjes;

- 2) të zbatojë procesin e pajtimit, me pëlqimin e personit që konsideron se është i diskriminuar dhe organit, personit tjetër juridik apo fizik për të cilin konsiderohet se ka kryer diskriminim, për të mundësuar përfundimin e pajtimit jashtëgjyqësor, në pajtim me ligjin që rregullon procesin e ndërmjetësimit;
- 3) të informojë opinionin për paraqitjet e dukurive të rëndësishme të diskriminimit;
- 4) sipas nevojës, të kryejë hulumtime në fushën e diskriminimit;
- 5) të mbajë evidencën e posaçme mbi ankesat e paraqitura lidhur me diskriminimin;
- 6) të grumbullojë dhe të analizojë të dhënat statistikore mbi rastet e diskriminimit;
- 7) të ndërmarrë aktivitete për ngritjen e vetëdijes mbi çështjet që lidhen me diskriminimin.

Paraqitja e ankesës

Neni 22

Kushdo që konsideron se është i diskriminuar me aktin, veprimin ose mosveprimin e organit dhe personave të tjerë fizikë dhe juridikë, mund t'i drejtohet me ankesë Mbrojtësit/es.

Ankesën sipas paragrafit 1 të këtij neni, Mbrojtësit/es, mund ta paraqesin edhe organizatat ose individët që merren me mbrojtjen e të drejtave njerëzore, me pëlqimin e personit ose grupit të personave të diskriminuar.

Trajtimi në bazë të ankesave sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, zbatohet në pajtim me rregullat me të cilat është përcaktuar mënyra e punës së Mbrojtësi/es, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Raportet e Mbrojtësit/es

Neni 23

Mbrojtësi/ja, në pjesën e veçantë të raportit vjetor, njofton Kuvendin e Malit të Zi mbi dukuritë e vëna re të diskriminimit dhe aktivitete e ndërmarra si dhe propozon rekomandimet dhe masat për zhdukjen e diskriminimit.

Mbi dukuritë e vëna të diskriminimit Mbrojtësi/ja mund t'i paraqesë Kuvendit të Malit të Zi raportin e veçantë, nëse këtë e kërkon nga ai/ajo grupi punues kompetent i Kuvendit të Malit të Zi ose nëse Mbrojtësi/ja vlerëson se këtë e kërkojnë sidomos arsyet me rëndësi të veçantë.

IV. MBROJTJA GJYQËSORE

Procesi para gjykatës

Neni 24

Kushdo që mendon se është cunguar me sjelljen diskriminuese të organit, personit tjetër juridik apo fizik, ka të drejtën e mbrojtjes para gjyqit, në pajtim me ligjin.

Procesi fillohet me ankesën.

Në procedurën sipas paragrafit 2 të këtij neni, zbatohen dispozitat e ligjit me të cilat rregullohet çështja dypalëshe e procesit gjyqësor, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Procedura nga paragrafi 2 i këtij neni është urgjente.

Në kontestimin e mbrojtjes nga diskriminimi rishqyrtimi është gjithmonë i lejuar.

Kompetenca vendore

Neni 25

Në procesin e mbrojtjes nga diskriminimi në vend, krahas gjyqit të kompetencave të përgjithshme vendore, është kompetent edhe gjyqi në rajonin e të cilit është vendbanimi, gjegjësisht selia e paditësit/es.

Ankesa

Neni 26

Me ankesën sipas nenit 24 paragrafi 2 i këtij ligji, mund të kërkohet edhe:

- 1) përcaktimi që i/e akuzuari/a ka vepruar në mënyrë diskriminuese ndaj paraqitësit/es të ankesës;
- 2) ndalimi i kryerjes së punës që kërcënon diskriminim, gjegjësisht ndalimi i përsëritjes së veprës diskriminuese;
- 3) dëmshpërblimi i dëmit, në pajtim me ligjin;
- 4) publikimi i vendimit me të cilën është përcaktuar diskriminimi me shpenzimet e të pandehurit/es në medime, nëse diskriminimi është kryer nëpërmjet medieve.

Në rastet nga paragrafi 1 pika 1 dhe 2 të këtij neni, kërkesa për ankesë paraqitet së bashku me kërkesën për mbrojtjen e të drejtave për të cilat vendoset në procesin gjyqësor, nëse këto kërkesa janë të ndërlidhura dhe kanë bazë të njëjtë faktike dhe juridike.

Ankesa nga paragrafi 1, pika 1 dhe 2 e këtij neni, mund të paraqitet në mënyrë të pavarur vetëm nëse akti ose veprimi diskriminues nuk ka pasur si pasojë humbjen ose shkeljen e ndonjë të drejte.

Afati për paraqitjen e ankesës

Neni 27

Ankesa sipas nenit 24, paragrafi 2, të këtij ligji, mund të paraqitet në afatin prej 90 ditësh nga dita e njoftimit për diskriminimin e kryer.

Masat e përkohshme

Neni 28

Para fillimit ose gjatë procesit sipas ankesës nga neni 24 i këtij ligji, gjyqi mundet, me propozimin e palës, të përcaktojë masat e përkohshme.

Në propozimin për të dhënë masat e përkohshme duhet të bëhet e besueshme se masa është e nevojshme për të parandaluar rrezikun e shfaqjes së dëmit të pashlyeshëm, sidomos shkeljen e rëndë të të drejtave për trajtim të barabartë ose parandalim të dhunës.

Për propozimin për të dhënë masën e përkohshme, gjyqi është i obliguar që të sjellë vendimin pa shtyrje.

Procedura sipas paragrafit 1 të këtij neni, zbatohet në përputhje me dispozitat e ligjit për procedurën ekzekutive.

Barra e argumentimit

Neni 29

Nëse paraqitësi/ja e kërkesës vërteton se i/e akuzuara/a e ka kryer aktin e diskriminimit, barra e argumentimit që për arsye të këtij akti nuk ka çuar tek shkelja e barazisë së të drejtave edhe para ligjit, kalon mbi të akuzuarin/en.

Dispozita e paragrafit 1 të këtij neni nuk ka të bëjë me kundërvajtje dhe procedura penale.

Personat e tjerë që mund të paraqesin ankesë

Neni 30

Ankesë, sipas nenit 26, paragrafi 1, pikat 1, 2 dhe 4 të këtij Ligji, në emër të personit të diskriminuar, mund të paraqesin edhe organizatat ose individët/et që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Dispozita nga paragrafi 1 i këtij neni mund të paraqitet vetëm me pëlqimin me shkrim të personit ose grupit të personave të diskriminuar.

Njoftimi i Mbrojtësit/es

Neni 31

Paraqitësi/ja e ankesës nga neni 24 dhe 30 i këtij ligji që ka paraqitur ankesën Mbrojtësit/es është i obliguar që në formë të shkruar të njoftojë Mbrojtësin/en mbi fillimin e procesit gjyqësor.

V. MBIKËQYRJA E INSPEKTIMIT

Roli i inspektimit

Neni 32

Mbikëqyrjen e inspektimit mbi zbatimin e këtij ligji në raport me diskriminimin në fushën e punës dhe punësimit, mbrojtjes në punë, mbrojtjes shëndetësore, arsimimit, ndërtimtarisë, komunikacionit, turizmit dhe në fushat e tjera e kryejnë inspektimet kompetente për këto fusha, në pajtim me ligjin.

VI. EVIDENTIMI

Mbajtja e evidencës

Neni 33

Organet, personat e tjerë juridikë dhe fizikë janë të obliguar të mbajnë evidencë të posaçme për të gjitha rastet e paraqitura të diskriminimit dhe të dhënat nga evidenca t'ia paraqesë me kohë Mbrojtësit/es.

Gjykatat, organet e inspektimit dhe organet për kundërvajtje janë të obliguara të mbajnë evidencën mbi ankesat e paraqitura lidhur me diskriminimin dhe të dhënat t'ia paraqesë në kohë Mbrojtësit/es.

Përmbajtjen më të afërt dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës sipas paragrafit 2 të këtij neni, e përcakton organi i administratës shtetërore i ngarkuar për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtat e Pakicave.

VII. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Kundërvajtjet

Neni 34

Me gjobë me para prej dyqind deri treqind herë të vlerës së pagës minimale në Mal të Zi do të dënohet për kundërvajtje personi juridik ose sipërmarrësi, nëse:

- 1) refuzon ofrimin e shërbimeve publike, kushtëzon ofrimin e shërbimeve me kushte që nuk kërkohen nga personat ose grupi i personave të tjerë, vonon ose pezullon ofrimin e shërbimeve, edhe pse personi ose grupi i personave kanë kërkuar dhe plotësuar kushtet për ofrim të shërbimit në kohën e duhur para personave të tjerë (neni 11, paragrafi 1, pikat 2, 3 dhe 4);
- 2) parandalon, kufizon ose vështirëson shfrytëzimin e qasjeve në objektet dhe sipërfaqet në përdorim publik personave me lëvizshmëri të kufizuar dhe personave me invaliditet (neni 18, paragrafi 2);
- 3) paraqet ankesën pa pëlqimin e shkruar të personit apo grupit të personave të diskriminuar (neni 30, paragrafi 2);
- 4) nuk mban evidencën e posaçme për të gjitha rastet e paraqitura të diskriminimit ose të dhënat nga evidenca nuk ia paraqet në kohë Mbrojtësit/es (neni 33, paragrafi 1);
- 5) nuk mban evidencën e posaçme për të gjitha ankesat e paraqitura lidhur me diskriminimin ose të dhënat nga evidenca nuk i paraqet në kohë Mbrojtësit/es (neni 33, paragrafi 2).

Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni do të ndëshkohet edhe personi përgjegjës në organe ose personi juridik apo fizik me gjobë me para në vlerën prej dyqind pagash minimale në Mal të Zi.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Procedurat sipas ankesave

Neni 35

Procedurat sipas ankesave që kanë të bëjnë me diskriminim dhe janë paraqitur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundohen në pajtim me dispozitat që janë zbatuar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Aktet nënligjore

Neni 36

Akti nënligjor nga neni 33, paragrafi 3, i këtij ligji do të miratohet në afatin prej 6 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Hyrja në fuqi

Neni 37

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Malit të Zi”.

KUVENDI I MALIT TË ZI
MBLEDHJA E 24^{të}

Kryetari
Ranko Krivokapiq